



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 1.11.2021

Lënda: Lidhur me dy aktet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vendime për magjistraten Alkelina Gazidedja

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në seancën gjyqësore të datës 28.10.2021, pasi dëgjuam prapësimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Gazidedja, referuar katër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për çështje të gjykuara prej saj, që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ia kishte adresuar këtij institucioni, në kuadër të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik kërkoi t'i vihen në dispozicion dhe të njihet me këto vendime, me qëllim që të mbajë një qëndrim specifikisht për to.

Pasi i shqyrtuam ato dhe, konkretisht, vendimet e ILD-së, si vijon:

1. Vendim nr.*** prot., datë **.12.2020, “Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistrates Alkelina Gazidedja, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë” dhe
2. Vendim nr.*** prot., datë **.2.2021, “Për pezullimin e hetimit disiplinor të filluar me iniciativë ndaj magjistrates Alkelina Gazidedja, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë”;

Komisioneri Publik vlerëson se ato nuk ndikojnë në shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA